



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

AVOKATIT TË POPULLIT

Ex officio nr. 854/2026

Lidhur me vëzhgimin e mbarëvajtjes së Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 7 qershor 2026

Drejtuar:

Z. Kreshnik Radoniqi, kryetar
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Prishtinë, më 17 gusht 2026

Qëllimi

Raporti paraqet qëndrimet dhe vlerësimet e Avokatit të Popullit lidhur me mbarëvajtjen e procesit të zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 7 qershor 2026, nga perspektiva e respektimit të të drejtave zgjedhore. Këto vlerësime mbështeten në informacionet e siguruara nga ekipet vëzhguese të Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP) gjatë monitorimit të procesit zgjedhor në terren, në ditën e zgjedhjeve, si dhe në ankesat individuale që pranuan nga qytetarët.

Raporti u iniciua sipas detyrës zyrtare (ex officio) dhe synon t'i identifikojë sfidat dhe parregullsitë e evidentuara gjatë procesit zgjedhor, duke paraqitur gjetjet kryesore dhe rekomandimet e nevojshme për avancimin e respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave zgjedhore në të ardhmen.

Baza kushtetuese dhe ligjore

1. Në pajtim me nenin 132, paragrafi 1, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.”* Kushtetuta më tej në nenin 135, paragrafi 3, përcakton: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*
2. Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - *“Për t'i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit (neni 16, paragrafi 1);*
 - *Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime qoftë për t'iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut (neni 16, paragrafi 1);*
 - *publikon raporte dhe bën rekomandime mbi politikat dhe praktikat për të luftuar diskriminimin dhe promovuar barazinë (neni 16, paragrafi 15);*
 - *të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2);*
 - *të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avansimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5);*

- *t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6);*
- *Avokati i Popullit mund t'i këshillojë dhe t'u rekomandojë autoriteteve të Republikës së Kosovës për programet dhe politikat e tyre për të siguruar mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Kosovës (neni 18, paragrafi 3)."*

Instrumentet ligjore të aplikueshme

3. E drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, si e drejtë themelore civile dhe politike, është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Neni 45 i Kushtetutës [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] përcakton: *"Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë. Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike."*
4. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, në nenin 21, parasheh: *"Secili ka të drejtë të marrë pjesë në qeverisjen e vendit të vet, drejtpërsëdrejti ose me anë të përfaqësuesve të zgjedhur lirisht. Secili ka njësoj të drejtë të hyjë në shërbimet publike të vendit të vet. Vullneti i popullit është bazë e pushtetit shtetëror; ky vullnet duhet të shprehet në zgjedhjet e herëpashershme dhe të lira, të cilat duhet të jenë të përgjithshme dhe me votë të barabartë, si dhe me votim të fshehtë ose sipas procedurës përkatëse të votimit të lirë."*
5. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në nenin 3 të Protokollit shtesë nr. 1 të Konventës shprehimisht përcakton: *"Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të organizojnë në intervale të arsyeshme kohore, zgjedhje të lira me votim të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit për zgjedhjen e organit ligjvënës."*
6. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 25, pika b, lidhur me të drejtën për zgjedhje parasheh: *"Çdo qytetar ka të drejtë dhe mundësi, që pa asnjë nga dallimet e përmendura në nenin 2 dhe pa kufizime të paarsyeshme: Të votojë dhe të zgjedhet gjatë zgjedhjeve të vërteta të herëpashershme, me votim të përgjithshëm dhe të barabartë dhe me vota të fshehta, të cilat sigurojnë shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve."*
7. Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Protokolli Opsional, në nenin 29 [Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike] garanton mbrojtjen e së drejtës për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, e cila parasheh: *"Shtetet Palë duhet tu garantojnë personave me aftësi të kufizuar të drejtat politike dhe mundësinë për t'i gëzuar ato njësoj si pjesa tjetër e popullësisë dhe duhet të marrin përsipër:*
 - (a) *Tu garantojnë personave me aftësi të kufizuar pjesëmarrjen e plotë dhe efektive në jetën politike dhe publike njësoj si gjithë të tjerët, drejtpërsëdrejti apo nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, duke përfshirë edhe të drejtën dhe mundësinë e personave me aftësitë kufizuar për të votuar dhe për tu zgjedhur, ndër të tjera duke:*
 - (i) *Siguruar që procedurat, facilitetet dhe materialet e votimit të jenë të*

përshtatshme, të aksesueshme dhe të thjeshta për tu kuptuar dhe përdorur;

(ii) Mbrojtur të drejtën e personave me aftësi të kufizuar për të votuar me votë të fshehtë në zgjedhje dhe referendume publike, pa kërcënim, për të kandiduar në zgjedhje, për të ushtruar funksione publike dhe për të kryer të gjitha funksionet publike në të gjitha nivelet e qeverisë, duke lehtësuar përdorimin e teknologjive asistuese dhe të reja, ne rastet e përshtatshme;

(iii) Garantuar shprehjen e vullnetit të lirë të personave me aftësi të kufizuar si zgjedhës dhe për këtë qëllim, kur është e nevojshme, me kërkesën e tyre, lejohet asistenca në votim nga një person i zgjedhur prej tyre.

(b) garantimin e një ambienti, në të cilin personat me aftësi të kufizuar mund të marrin pjesë në mënyrë efektive dhe të plotë në dirigjimin e çështjeve publike, pa diskriminim dhe njësoj si të tjerët dhe të inkurajojë pjesëmarrjen e tyre në çështjet publike, duke përfshirë:

(i) Pjesëmarrjen në organizatat joqeveritare dhe shoqatat që kanë të bëjnë me jetën publike dhe politike në vend dhe në aktivitetet dhe administrimin e partive politike;

(ii) Krijimin apo pjesëmarrjen në organizata të personave me aftësi të kufizuar për të përfaqësuar personat me aftësi të kufizuar në nivele ndërkombëtare, kombëtare, rajonale dhe lokale.”

8. Ligji nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës përcakton qartë rregullat e organizimit të sistemit zgjedhor, duke përfshirë rregullat për përgatitjen, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen dhe shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

9. Ligji nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 4 - Parimet themelore, përcakton:

“1. Mbajtja dhe administrimi i zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës dhe legjislacioni përkatës zgjedhor udhëhiqen nga parimet në vijim:

1.1. zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës mbahen në bazë të votës së lirë, të përgjithshme, të barabartë, të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë në përputhje me këtë ligj dhe rregullat e KQZ-së;

1.2. çdo shtetas i Republikës së Kosovës është i barabartë në ushtrimin e të drejtës për të votuar dhe për t’u zgjedhur pa diskriminim në bazë të racës, etnisë, ngjyrës, gjuhës, gjinisë, besimit fetar apo bindjes politike, arsimit, përkatësisë sociale apo ndonjë kriteri tjetër të ngjashëm në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

1.3. liria dhe fshehtësia e votës është e garantuar. Askush nuk ka të drejtë të pengojë ndonjë qytetar për të votuar, të detyrojë atë të votojë në një mënyrë të caktuar, të mbajë atë përgjegjës për votën, ose të kërkojë kundër dëshirës së tij/saj që të zbulojë votën e tij/saj ose arsyet për mos votim;

1.4. zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës reflektojnë përfaqësimin gjeografik të të gjitha rajoneve të Kosovës; [...].”

10. Neni 6 [E drejta për të votuar] i Ligjit nr. 08/L-228 saktëson: “Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve,

gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë. E drejta e votës mund të kufizohet me vendim gjyqësor.”

11. Lidhur me votimin brenda dhe jashtë vendit, ligji i lartpërmendur, në nenin 7 [Votimi brenda dhe jashtë Kosovës], paragrafët 1 dhe 2, përcakton: “Çdo shtetas me të drejtë vote ka të drejtë të votojë në Kosovë në ditën e zgjedhjeve dhe në komunën ku ai apo ajo është i regjistruar, me kusht që emri i tij apo saj paraqitet në Regjistrin Qendror Civil. Shtetasi i Republikës së Kosovës, që jeton jashtë vendit, ka të drejtë të votojë në zgjedhje pas regjistrimit të suksesshëm sipas procedurave dhe afateve kohore të përcaktuara në këtë ligj.”
12. Ky ligj, në vijim, lidhur me të drejtën e votës dhe fshehtësinë e votës, në nenin 89, paragrafët 1, 5 dhe 6, parasheh: “Votuesi më të drejtë për të votuar ka të drejtë vote nëse ai/ajo është i regjistruar në Kosovë ose ka aplikuar suksesshëm për votim jashtë Kosovës siç përcaktohet në nenet 6 dhe 7 të këtij ligji [...]. Votuesi i cili është me aftësi të kufizuara në atë mënyrë që nuk është në gjendje të shënojë ose hedh fletëvotimin, mund të ndihmohet nga një person tjetër i zgjedhur nga votuesi, me kusht që personi që ndihmon është votues në qendrën e njëjtë të votimit me votuesin. Personi i tillë e ndihmon vetëm një votues dhe nuk është anëtar i KVV-së ose vëzhgues i akredituar, përjashtimisht për anëtarët e ngushtë të familjes. Për këtë lloj të votimit, KQZ do t'i caktojë kriteret me rregullën zgjedhore. Kryesuesi i Këshillit të vendvotimit obligohet që të shënojë në librin e votimit, rastet e votimit me asistencë, duke përfshirë arsyet konkrete dhe të shënojë të dhënat personale të votuesit dhe të dhënat personale të personit që ka ndihmuar.”

Vëzhgimi i mbarëvajtjes së Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më 7 qershor 2026

13. Avokati i Popullit, duke u bazuar në mandatin e tij kushtetues dhe ligjor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në rastin konkret të së drejtës zgjedhore, vëzhgoi mbarëvajtjen e Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 7 qershor 2026.
14. Vëzhgimi i Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 7 qershor 2026, u realizua nga zyrtarët e IAP-së, të akredituar nga KQZ-ja si vëzhgues, në përputhje me legjislacionin dhe rregullat përkatëse zgjedhore.
15. Duke pasur në qendër të vëmendjes mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të garantuara që lidhen me zgjedhjet e lira, përkatësisht të drejtën për të votuar dhe për t'u zgjedhur, të drejtën për votim të lirë dhe të fshehtë, si dhe parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, me theks të veçantë të kategoritë e cënueshme të votuesve dhe personat që votojnë në kushte të veçanta, IAP-ja realizoi vëzhgimin e zgjedhjeve në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës (38), si dhe në institucionet ku votojnë kategori të veçanta të qytetarëve, përfshirë Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, Qendrën e Paraburgimit në Pejë, Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë, Qendrën e Paraburgimit në Gjilan, Qendrën e Paraburgimit në Prizren, Qendrën e Paraburgimit në Lipjan, Burgun e Dubravës, Burgun e Smrekonicës, Burgun e Sigurisë së Lartë, Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), Qendrën për Rehabilitim në Shtime, si dhe Shtëpinë për Përkujdesjen e të Moshuarve në Prishtinë.
16. Procesi i vëzhgimit u realizua nga zyrtarët e IAP-së nëpërmjet një strukture të organizuar

dhe të koordinuar, të përbërë nga 19 ekipe, përkatësisht 18 ekipe mobile dhe një ekip kujdestar në Zyrën Qendrore të IAP-së në Prishtinë.

17. Zyra Qendrore e IAP-së shërbeu si pikë e komunikimit të vazhdueshëm me ekipet monitoruese dhe institucionet relevante. Po ashtu, gjatë ditës së zgjedhjeve, Zyra Qendrore ishte e hapur për pranimin e ankesave, si në formë fizike, ashtu edhe nëpërmjet linjës telefonike dhe mjeteve elektronike të komunikimit.

18. Vëzhgimi, veçanërisht, është fokusuar në aspektet si në vijim:

- a) nëse procesi i votimit ka filluar me kohë;
- b) nëse ka pasur raste që kanë cenuar rrjedhën normale të votimit;
- c) nëse mjedisi ku ndodhen qendrat e votimit (jashtë dhe brenda) ofrojnë siguri dhe mundësi votimi pa presion, kërcënim, ndikim etj.
- d) nëse qendrat e votimit kanë pasur qasshmëri infrastrukturore, veçanërisht për personat me aftësi të kufizuara;
- e) identifikimin e votuesve në regjistrin e votuesve në vendvotime;
- f) nëse janë respektuar rregullat e vendosjes së kamerave në vendvotime;
- g) mbarëvajtja e procesit të vëzhgimit nga vëzhguesit;
- h) nëse ka pasur parregullsi në procesin e votimit;
- i) nëse është respektuar ruajtja e fshehtësisë së votës dhe ruajtja e vullnetit elektoral të votuesve;
- j) nëse janë respektuar të drejtat e votimit të personave me nevoja të veçanta;
- k) mbarëvajtja e procesit zgjedhor në qendrat e ndalimit, të paraburgimit, në burgje, në spitale, në shtëpitë e të moshuarve etj.

Të gjeturat në terren nga vëzhgimi

19. Sipas raportimeve të ekipeve vëzhguese të IAP-së, procesi i votimit dhe mbarëvajtja e Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 7 qershor 2026, në përgjithësi, u vlerësuan si të rregullta, të lira, të qeta dhe demokratike. Në qendrat e monitoruara, vendvotimet u hapën me kohë, materialet zgjedhore ishin shpërndarë sipas planifikimit, ambienti ishte i sigurt dhe i qetë, ndërsa procesi i votimit u zhvillua pa incidente serioze që do të mund të ndikonin në integritetin e procesit zgjedhor. Po ashtu, në përgjithësi u evidentua prania e vëzhguesve, mediave dhe zyrtarëve policorë, si dhe respektimi i procedurave themelore të votimit.

20. Megjithatë, gjatë procesit të vëzhgimit u evidentuan disa mangësi dhe sfida që ndërlikohen kryesisht me ushtrimin efektiv të së drejtës së votës nga kategoritë më të cenueshme të votuesve. Mangësitë e evidentuara janë si më poshtë:

21. Lidhur me procesin e votimit me asistencë:

- i) Një nga çështjet më të shpeshta të raportuara ishte pamundësia e realizimit të së drejtës së votës për disa persona që pretendonin se kishin nevojë për asistencë gjatë votimit, për shkak të mospranimit të vërtetimit mjekësor. Në raste të caktuara, votuesit ishin pajisur me vërtetime mjekësore të lëshuara nga Qendrat e Mjekësisë Familjare, e jo nga specialisti përkatës, si pasojë e mungesës së informimit të duhur lidhur me kushtet për realizimin e kësaj të drejte.
- ii) Si gjetje tjetër u raportua mungesa e informimit të duhur të votuesve me vështirësi në shkrim-lexim se për këtë kategori të votuesve nuk parashihej votimi me asistencë.

22. Lidhur me qasjen e barabartë për personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit:

- i) Një sfidë tjetër e përsëritur kishte të bënte me qasjen fizike në qendrat e votimit. Në disa komuna, vendvotimet ishin të vendosura në katet e sipërme të objekteve, të cilave u mungonte infrastruktura e nevojshme ndihmëse për personat me nevoja të veçanta. Në raste të tjera, mungonte infrastruktura e nevojshme për qasje të personave me aftësi të kufizuara dhe personave të moshuar. Këto rrethana ua vështirësuan këtyre kategorive qasjen në vendvotime dhe ndikuan në ushtrimin efektiv të së drejtës së tyre për të votuar.
23. Lidhur me fletëvotimet e përshtatura për personat me dëmtime në të parë:
- i) Në disa vendvotime, ekipet monitoruese evidentuan mungesë të fletëvotimeve në alfabetin Braille, gjë që kufizoi mundësinë e votimit të pavarur për personat me dëmtime në të parë.
24. Lidhur me listat e votuesve dhe dokumentet e identifikimit:
- i) Disa persona nuk patën mundësi të votonin për shkak të dokumenteve të identifikimit të skaduara ose për shkak se nuk figuronin në listat e votuesve.
 - ii) Mospërfshirja e disa personave të privuar nga liria ose e rezidentëve të institucioneve në listën e votuesve.
25. Lidhur me çështjet informative dhe organizative:
- i) Mungesa e tavolinave ndihmëse në disa qendra votimi për orientimin e votuesve.
26. Të gjeturat e raportuara nga Organizatat e Shoqërisë Civile:
- i) Shoqata e të Verbërve e Republikës së Kosovës njoftoi IAP-në se, gjatë procesit zgjedhor të 7 qershorit, vërejti mungesë të njohurive adekuate për përdorimin e shabllojeve në alfabetin Braille. Po ashtu, kjo shoqatë theksoi mungesën e shabllojeve përkatëse në disa qendra të votimit.
 - ii) Shoqata Kosovare e të Shurdhërve, në tryezën e organizuar nga Avokati i Popullit në kuadër të Forumit për Dialog ndërmjet IAP-së dhe OShC-ve, ngriti çështjen e informimit të komunitetit të shurdhër lidhur me procesin zgjedhor për zgjedhjet e 7 qershorit. Drejtori i kësaj shoqate theksoi se, ndryshe nga zgjedhjet e kaluara, në këto zgjedhje mungoi informimi apo interpretimi në gjuhën e shenjave në videot informuese të KQZ-së.
27. Megjithatë këto raste nuk duket se ndikuan në integritetin e përgjithshëm të procesit zgjedhor, ato tregojnë nevojën për përmirësimin e qasjes, informimit, standardizimit të procedurave dhe garantimit të pjesëmarrjes së barabartë të të gjithë qytetarëve në procesin zgjedhor.

Analiza ligjore lidhur me të gjeturat

28. E drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur garantohet me nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili përcakton parimet e votës personale, të barabartë, të lirë dhe të fshehtë, si dhe detyrimin e institucioneve për të mbështetur pjesëmarrjen demokratike. Nenit 45 i Kushtetutës [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] përcakton: *“Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë. Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike.”*

29. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollet e saj (KEDNJ) në nenin 3 të Protokollit nr. 1 përcakton më sa vijon: *“Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të organizojnë në intervale të arsyeshme kohore, zgjedhje të lira me votim të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit për zgjedhjen e organit ligjvënës.”* Të drejtat e mbrojtura me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së janë të drejta qenësore drejt ruajtjes së themeleve dhe vlerave demokratike që udhëhiqen nga sundimi i ligjit. Megjithatë, këto të drejta nuk janë absolute. Praktika gjyqësore e GjEDNJ-së pranon se ato mund t'i nënshtrohen kufizimeve të nënkuptuara, duke ua njohur shteteve një margjinë të konsiderueshme vlerësimi në rregullimin e çështjeve zgjedhore¹.
30. Lidhur me gjetjet e evidentuara gjatë vëzhgimit të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 7 qershor 2026, Avokati i Popullit vëren se një pjesë e konsiderueshme e mangësive të konstatuara janë të natyrës së njëjtë me ato të evidentuara edhe gjatë monitorimit të tri proceseve zgjedhore të zhvilluara gjatë vitit 2025, për të cilat Avokati i Popullit, më 3 shkurt 2026, iu drejtua KQZ-së me Raport me rekomandime Ex-officio nr. 1667/2025², nëpërmjet të cilit i rekomandoi KQZ-së të ndërmarrë veprime për: Standardizimin e informimit dhe orientimit në të gjitha qendrat e votimit; për sigurimin e qasjes fizike të plotë për personat me aftësi të kufizuara dhe për personat e moshuar; për sigurimin në kohë dhe të plotë të materialeve zgjedhore, përfshirë fletëvotimet në Braille, për garantimin e fshehtësisë së votës, veçanërisht në institucionet korrektuese dhe në të paraburgimit; për standardizimin e procedurave të votimit me asistencë; për përmirësimin e saktësisë dhe menaxhimit të listave të votuesve; për forcimin e kapaciteteve organizative, administrative dhe infrastrukturore të procesit zgjedhor; si dhe për përmirësimin e procedurave dhe mekanizmave të votimit jashtë vendit.
31. Avokati i Popullit e mirëpriti përgjigjen e KQZ-së dhe angazhimin e shprehur për adresimin e mangësive të evidentuara, të cilat në rrethana të caktuara mund të paraqesin pengesa në ushtrimin efektiv të së drejtës së votës. Megjithatë, bazuar në gjetjet e siguruara gjatë vëzhgimit të zgjedhjeve të fundit, Avokati i Popullit vlerëson se KQZ-ja ndërmori hapa konkretë për zbatimin e një pjese të rekomandimeve të adresuara në Raportin me rekomandime të lartshënuar, megjithatë, masat e ndërmarra nuk rezultuan plotësisht efektive në eliminimin e të gjitha mangësive të konstatuara. Kjo për faktin se, edhe gjatë këtij procesi zgjedhor, u evidentuan raste në të cilat votuesve u është vështirësuar ose pamundësuar ushtrimi i së drejtës për të votuar, duke ndikuar në realizimin efektiv të kësaj të drejte kushtetuese.
32. Lidhur me rekomandimin e adresuar KQZ-së: *T'i rishikojë dhe t'i standardizojë procedurat për votimin me asistencë, duke nxjerrë udhëzime të qarta dhe konkrete për votuesit e kategorive të cënueshme, në mënyrë që të mos u pamundësohet ushtrimi i votës*, Avokati i Popullit vëren se KQZ-ja, më 27 prill 2026, miratoi ndryshimet dhe plotësimet e *Rregullores Zgjedhore Nr. 12/2024 për Votimin, Numërimin në Vendvotim dhe Menaxhimin e Vendvotimit*. Në këtë drejtim, KQZ-ja saktësoi dokumentacionin që kërkohet për realizimin e votimit me asistencë nga personat me aftësi të kufizuara, duke

¹ Shih: Yumak dhe Sadak kundër Turqisë, paragrafi 109.

² <https://oik-rks.org/2026/02/03/raport-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-1667-2025-lidhur-me-monitorimin-e-mbarevajtjes-se-zgjedhjeve-lokale-ne-republiken-e-kosoves-te-mbajtura-me-12-tetor-2025-te-zgjedhjeve-lokale-raundi-i-d/>

përcaktuar shprehimisht llojet e dokumenteve mjekësore nëpërmjet të cilave mund të dëshmohet nevoja për asistencë gjatë votimit³. Avokati i Popullit vlerëson se ky ndryshim përbën një hap pozitiv drejt rritjes së sigurisë juridike dhe qartësisë procedurale, pasi, para ndryshimit të rregullores, kërkesa për dëshmimin e aftësisë së kufizuar ishte e formuluar në mënyrë të përgjithshme, përkatësisht përmes referimit në “dokumente përkatëse”, pa specifikuar natyrën dhe llojin e dokumentacionit të nevojshëm. Si rezultat, saktësimi i kriterëve kontribuoi në orientimin më të qartë të qytetarëve lidhur me dokumentacionin që kërkohet për realizimin e kësaj të drejte.

33. Megjithatë, bazuar në gjetjet e evidentuara gjatë vëzhgimit në ditën e zgjedhjeve të 7 qershorit 2026, Avokati i Popullit konstatoi se, pavarësisht ndryshimeve të ndërmarra në kuadrin normativ, një numër votuesish nuk kanë qenë të informuar në mënyrë adekuate për kushtet dhe dokumentacionin e nevojshëm për votimin me asistencë. Në disa raste, mungesa e informacionit të mjaftueshëm rezultoi në pamundësinë e ushtrimit të së drejtës së votës, pasi votuesit nuk kanë poseduar dokumentacionin e kërkuar dhe, rrjedhimisht, nuk kanë mundur të përfitonin nga asistenca gjatë votimit. Për këto arsye, Avokati i Popullit vlerëson se, krahas përmirësimeve të realizuara në aspektin normativ, mbetet e nevojshme që KQZ-ja t’i intensifikojë aktivitetet informuese dhe vetëdijësuese për qytetarët, me qëllim që kriteret dhe procedurat për votimin me asistencë të jenë të qarta, të kuptueshme dhe lehtësisht të qasshme për të gjitha kategoritë e votuesve që mund të kenë nevojë për këtë formë mbështetjeje.
34. Për sa i përket qasjes fizike adekuate për personat me aftësi të kufizuara dhe për të moshuarit, në disa qendra votimi u vërejt se kjo gjetje e adresuar vazhdoi me të njëjtat barrierë. Edhe në zgjedhjet e mëhershme u evidentua se një numër i konsiderueshëm vendvotimesh u vendosën në kate të larta të objekteve shkollore, pa sigurimin e kushteve fizike, si pjerrina dhe ashensorë, gjë që vështirësuan qasjen fizike të personave me aftësi të kufizuara dhe atyre të moshuar. Në këtë drejtim u evidentuan raste kur të moshuarit, në mungesë të infrastrukturës ndihmës për t’u ngjitur shkallëve, nuk arritën ta ushtronin të drejtën e votës. Avokati i Popullit rikujton se Rregullorja nr. 05/2024, që rregullon çështjen e themelimit dhe menaxhimit të qendrave të votimit, në nenin 9, paragrafi 1, lidhur me vendndodhjen e vendvotimeve, përcakton: *“Vendvotimet vendosen duke filluar në katin përdhesë, në një vend të përshtatshëm për hyrje-dalje, për t’u mundësuar votuesve të krijojnë rresht dhe të qëndrojnë në të, dhe kur është e mundur, vendi për hyrje-dalje të jetë i rrafshët, ashtu që personat me aftësi të kufizuara të mund të hyjnë dhe të dalin në mënyrë të papenguar.”* Po ashtu, sipas praktikës së GjEDNj-së, përfshirë rastin *Toplak dhe Mrak kundër Sllovenisë* (2021): *“Shtetet duhet të garantojnë ushtrimin praktik dhe efektiv të së drejtës së votës, duke siguruar qasje adekuate për personat me aftësi të kufizuara, në mënyrë që ata të mund ta shprehin lirshëm dhe në fshehtësi vullnetin e tyre zgjedhor.”* Rrjedhimisht, sipas rregullave kërkohet që vendvotimet të vendosen duke filluar nga kati përdhes, në hapësira të përshtatshme për hyrje dhe dalje, me qëllim që personat me aftësi të kufizuara ose me nevoja të veçanta të kenë mundësi t’i qasen vendvotimit pa pengesa fizike, duke garantuar kështu ushtrimin e barabartë dhe efektiv të së drejtës së votës.

³ “Votuesi me aftësi të kufizuara, i cili nuk është në gjendje të shënojë ose ta hedh fletëvotimin, e kur kjo aftësi e kufizuar dëshmohet përmes dokumenteve mjekësore, të lëshuara nga specialist i fushës përkatëse (vërtetim, raport mjekësor, dokument apo librezë e lëshuar nga ministria përkatëse), mund të ndihmohet nga një person tjetër (asistuesi) nga e njëjta Qendër Votimi, i zgjedhur nga votuesi, duke ndjekur procedurën e KQZ-së.”

35. Sipas raportimeve të vëzhguesve, edhe në këto zgjedhje vazhduan të evidentoheshin mangësi lidhur me sigurimin e materialeve të përshtatura për personat me dëmtime në të parë. Në disa vendvotime u konstatua mungesa e shablloneve të fletëvotimeve në alfabetin Braille, duke kufizuar mundësinë e ushtrimit të pavarur të së drejtës së votës nga kjo kategori votuesish. Në të njëjtën linjë, Shoqata e të Verbërve e Republikës së Kosovës njoftoi Avokatin e Popullit se, gjatë monitorimit të procesit zgjedhor, evidentoi mungesë të njohurive praktike të një pjese të komisionerëve lidhur me përdorimin e shablloneve në alfabetin Braille, si dhe mungesë të këtyre shablloneve në disa qendra të votimit. Këto gjetje tregojnë se ende nuk është siguruar zbatimi i plotë dhe i njëtrajtshëm i detyrimeve të përcaktuara me Rregulloren Zgjedhore nr. 05/2024, e cila, në paragrafin 5 të nenit 8, obligon që çdo qendër votimi të pajiset me shabllone në alfabetin Braille dhe me komisionerë të trajnuar për asistimin e votuesve të verbër, me qëllim të garantimit të ushtrimit të pavarur dhe të barabartë të së drejtës së votës. Mungesa e materialeve ndihmëse dhe e njohurive të mjaftueshme për përdorimin e tyre cenon efektivitetin e masave të arsyeshme që duhet të ndërmerren për garantimin e pjesëmarrjes së barabartë të personave me aftësi të kufizuara në procesin zgjedhor. Për rrjedhojë, Avokati i Popullit vlerëson se KQZ-ja duhet të ndërmarrë masa shtesë për të siguruar që të gjitha qendrat e votimit të pajisen në kohë me shabllonet në alfabetin Braille, si dhe të organizojë trajnime praktike dhe të detyrueshme për komisionerët lidhur me përdorimin e tyre dhe asistimin e votuesve me dëmtime në të parë.
36. Po ashtu, gjatë vëzhgimit të zgjedhjeve të 7 qershorit 2026, ekipet e Avokatit të Popullit evidentuan raste kur votues me vështirësi në shkrim dhe lexim ishin pajisur me vërtetime mjekësore me qëllim të realizimit të votimit me asistencë. Këto raste tregojnë se vazhdon të ekzistojë paqartësi lidhur me informimin dhe kuptimin e duhur të procedurave të votimit për këtë kategori votuesish. Duke qenë se legjislacioni zgjedhor në fuqi nuk e parasheh votimin me asistencë për personat që nuk dinë shkrim dhe lexim, Avokati i Popullit vlerëson se KQZ-ja duhet të ndërmarrë masa shtesë për informimin dhe vetëdijesimin e votuesve, me qëllim që ata të kenë njohuri të mjaftueshme dhe të qarta lidhur me mënyrën e ushtrimit të së drejtës së votës.
37. Përkitazi me çështjen e ngritur nga Shoqata Kosovare e të Shurdhërve lidhur me qasjen në informata për procesin zgjedhor për personat me dëmtime në dëgjim, sipas kësaj shoqate, ndryshe nga proceset e mëparshme zgjedhore, gjatë zgjedhjeve të 7 qershorit 2026, videot informuese të KQZ-së nuk ishin të shoqëruara me interpretim në gjuhën e shenjave, duke kufizuar qasjen e kësaj kategorie votuesish në informata të rëndësishme lidhur me procedurat e votimit. Avokati i Popullit vlerëson se siguri i informatave të qasshme për të gjithë votuesit, pa dallim, përbën një element thelbësor për ushtrimin efektiv të së drejtës së votës. Për rrjedhojë, KQZ-ja duhet të sigurojë që materialet dhe fushatat informuese lidhur me procesin zgjedhor të jenë të qasshme edhe për personat me dëmtime në dëgjim, përfshirë përmes interpretimit në gjuhën e shenjave, sikurse në zgjedhjet e kaluara. Një qasje e tillë është në përputhje me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit dhe kontribuon në garantimin e pjesëmarrjes së barabartë të personave me aftësi të kufizuara në procesin zgjedhor.
38. Po ashtu, ekipet vëzhguese të IAP-së evidentuan se tavolinat ndihmëse ishin të vendosura vetëm në disa qendra votimi, por jo në të gjitha. Nga vëzhgimet në terren rezultoi se aty ku këto tavolina ishin funksionalizuar, ato kontribuan në orientimin dhe informimin e votuesve, veçanërisht të personave që kishin nevojë për asistencë shtesë

për të gjetur vendvotimin ose për të marrë informacione lidhur me procedurat e votimit. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit vlerëson se tavolinat ndihmëse paraqesin një mjet të rëndësishëm për lehtësimin e qasjes në procesin zgjedhor dhe konsideron se ato duhet të funksionalizohen në mënyrë të njëtrajtshme në të gjitha qendrat e votimit, në përputhje me kërkesat e Rregullores Zgjedhore nr. 05/2024.

39. Krahasuar me zgjedhjet e mbajtura gjatë vitit 2025, gjatë monitorimit të zgjedhjeve të mbajtura më 7 qershor 2026, nuk u evidentuan raste të ndryshimit ose zhvendosjes së qendrave të votimit që do të shkaktonin konfuzion apo pamundësi për ushtrimin e së drejtës së votës. Po ashtu, rastet e problemeve me Listën e Votuesve u paraqitën në numër dukshëm më të vogël. Megjithatë, ekipet vëzhguese evidentuan disa raste të izoluara kur votuesve nuk iu mundësua votimi për shkak të dokumenteve të identifikimit të skaduar ose për shkak se nuk figuronin në Listën e Votuesve, si dhe raste të mospërfshirjes së disa personave të privuar nga liria ose të rezidentëve të institucioneve në listën përkatëse të votuesve. Avokati i Popullit vlerëson se, ndonëse ka përmirësime në këtë drejtim, megjithatë nevojiten masa shtesë për përditësimin e saktë të Listës së Votuesve dhe informimin e duhur të qytetarëve lidhur me dokumentet e nevojshme për votim, me qëllim që edhe këto raste të veçuara të eliminohen në proceset e ardhshme zgjedhore.
40. Në kuadër të sqarimit dhe interpretimit të saktë të situatave të evidentuara nga vëzhguesit e IAP-së në raportimet e tyre lidhur me procesin zgjedhor gjatë ditës së votimit, Avokati i Popullit, më 7 korrik 2026, realizoi takim me kryetarin e KQZ-së, me qëllim të marrjes së informatave konkrete dhe sqarimeve lidhur me procesin e zhvilluar gjatë ditës së zgjedhjeve.

Konstatimet e Avokatit të Popullit

41. Avokati i Popullit, duke u bazuar në të gjeturat e paraqitura në këtë Raport, konstaton si në vijim:
42. Avokati i Popullit vlerëson se procesi zgjedhor i Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 7 qershor 2026, në përgjithësi, u zhvillua në mënyrë të qetë, demokratike dhe në përputhje me standardet themelore zgjedhore.
43. Avokati i Popullit konstaton se, pavarësisht përmirësimeve të evidentuara, rezulton se një pjesë e kufizuar e mangësive të evidentuara në proceset zgjedhore të vitit 2025 vazhdojnë të përsëriten. Këto mangësi ndikuan në ushtrimin praktik dhe efektiv të së drejtës së votës për një numër votuesish nga kategoritë e cënueshme.
44. Avokati i Popullit konstaton se qasja fizike në disa qendra votimi mbeti e kufizuar për personat me aftësi të kufizuara dhe për personat e moshuar, për shkak të barrierave infrastrukturore dhe vendosjes së vendvotimeve në kate të paarrtshme për këto kategori, në kundërshtim me standardet e qasshmërisë dhe parimin e ushtrimit efektiv të së drejtës së votës.
45. Avokati i Popullit konstaton se informimi i votuesve lidhur me procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e votimit me asistencë ishte prezent, por nuk ishte i mjaftueshëm, gjë që në raste të caktuara ndikoi në pamundësinë e ushtrimit të së drejtës së votës. Po ashtu, Avokati i Popullit konstaton se vazhdon të ekzistojë paqartësi lidhur me procedurat e votimit për personat me vështirësi në shkrim dhe lexim,

gjë që tregon nevojën për informim dhe udhëzime më të qarta për qytetarët lidhur me procedurat e zbatueshme.

46. Avokati i Popullit konstaton se në disa qendra votimi nuk janë siguruar shabllonet e fletëvotimeve në alfabetin Braille, ndërsa në raste të tjera komisionerët nuk kanë poseduar njohuritë e nevojshme për përdorimin e tyre, duke e vështirësuar mundësinë e votimit të pavarur për personat me dëmtime në të parë.
47. Avokati i Popullit konstaton se, për dallim nga zgjedhjet e kaluara, materialet informuese audiovizuale të KQZ-së nuk ishin plotësisht të qasshme për personat me dëmtime në dëgjim, për shkak të mungesës së interpretimit në gjuhën e shenjave, duke kufizuar qasjen e tyre në informata mbi procesin zgjedhor.
48. Avokati i Popullit konstaton se tavolinat ndihmëse nuk ishin të funksionalizuara në mënyrë të njëtrajtshme në të gjitha qendrat e votimit, ndonëse aty ku ishin të vendosura ndihmuan në orientimin dhe informimin e votuesve.
49. Bazuar në atë që u tha më lart, Avokati i Popullit konstaton se, megjithëse procesi zgjedhor i 7 qershorit 2026 shënoi përmirësime në disa aspekte organizative, mbetet e nevojshme ndërmarrja e masave shtesë për të siguruar një proces zgjedhor plotësisht të qasshëm, gjithëpërfshirës dhe në përputhje me Kushtetutën, me legjislacionin zgjedhor, si dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Duke u bazuar në rrethanat e cekura më lart, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: “[...] *ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.*”, si dhe bazuar në analizën ligjore të mësipërme, në cilësinë e rekomanduesit, i


REKOMANDON

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve:

- Të ndërmarrë masa që vendvotimet të vendosen në hapësira të qasshme për të gjithë, në mënyrë që personat me aftësi të kufizuara dhe personat e moshuar të kenë mundësi ta ushtrojnë të drejtën e votës në mënyrë të pavarur dhe pa pengesa.
- Të forcojë aktivitetet informuese dhe vetëdijesuese për procedurat e votimit me asistencë, duke siguruar që votuesit të informohen qartësisht për procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e kësaj të drejte.
- Të ofrojë informata dhe udhëzime të qarta për qytetarët lidhur me procedurat e votimit për personat me vështirësi në shkrim dhe lexim, në mënyrë që të shmangen keqkuptimet dhe pritjet e gabuara lidhur me mënyrën e ushtrimit të së drejtës së votës.
- Të sigurojë që të gjitha qendrat e votimit të pajisen me kohë me shabllonet e fletëvotimeve në alfabetin Braille, si dhe të shtojë trajnimet praktike për komisionerët lidhur me përdorimin e tyre dhe asistimin e votuesve me dëmtime në të parë.
- Të sigurojë interpretim të gjuhës së shenjave në materialet informuese audiovizuale lidhur me procesin zgjedhor.

- Të funksionalizojë tavolinat ndihmëse në të gjitha qendrat e votimit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit zgjedhor.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, [...] duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.”), ju lutemi të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

 Me nderime,
Naim Qelaj
Avokat i Popullit